



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit
dhe Jakup Krasniqit**

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Dr. Fidelma Donlon

Data: 26 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Njoftim për tërheqjen e bashkëmbrojtësit të Kadri Veselit

me një shtojcë konfidenciale

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

1. Në përputhje me rregullën 26(1) të Rregullores,¹ Administratorja informon Gjykatësin e Procedurës Paraprake për tërheqjen e bashkëmbrojtësit të z. Kadri Veseli ('z. Veseli').
2. Më 9 nëntor 2020, me kërkesë të mbrojtësit dhe në pajtim me pjesën 18 të Direktivës për Mbrojtësit, Administratorja miratoi z. Endrju Kejli QC si bashkëmbrojtës të z. Veseli, në pritje të vendimit përfundimtar për pranimin e z. Kejli në Listën e Mbrojtësve.²
3. Më pas, mbrojtësi e informoi Zyrën e Mbrojtjes se z. Kejli kishte ndërmend të tërhiqej si bashkëmbrojtës i z. Veseli.
4. Më 25 nëntor, në përputhje me pjesën 18(6) të Direktivës për Mbrojtësit, mbrojtësi i konfirmoi Zyrës së Mbrojtjes synimin e z. Kejli se do të tërhiqej dhe gjithashtu e informoi Zyrën e Mbrojtjes se përfundimi i kontratës me z. Kejli do të arrihej pa pasoja negative për interesat e z. Veseli dhe për kohëzgjatjen e procedurave. Në të njëjtën ditë, Administratorja miratoi tërheqjen e z. Keili si bashkëmbrojtës për z. Veseli.
5. Ky njoftim parashtrohet me klasifikimin publik, ndërsa shtojca 1 parashtrohet me klasifikimin konfidencial në përputhje me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, meqenëse ajo përmban informacion personal për mbrojtësin dhe bashkëmbrojtësin.

Numri i fjalëve (në origjinal): 240

/nënshkrimi/

Dr. Fidelma Donlon

Administratore

E enjte, 26 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë

¹ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'); *shih gjithashtu* Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015, nenet 21(4), 21(5), 34(7) dhe 41(4)(b).

² Njoftimi i emërimit të bashkëmbrojtësit për Kadri Veselin, KSC-BC-2020-06/F00067, 9 nëntor 2020, publik.